



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-22
31.01.2025
shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10¹, neni 24 dhe neni 79 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 57 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 dhe neni 51 paragrafët (1) dhe (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), duke vepruar sipas Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-5 datë 09.01.2025 plotësuese me, PA1 nr.08-5 datë 17.01.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-365/3 datë 30.01.2025, në seancën e 3-të mbajtur më 29.01.2025, miratoi si vijon:

V E N D I M
për vazhdimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive
TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë

1. Leja për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-353 datë 30.06.2016, vazhdohet për një periudhë prej 9 (nëntë) vjet, nga data 24.06.2025 deri më datë 23.06.2034.

2. Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, në pajtim me pikën nr.1. të këtij Vendimi, do t'i japë leje.

3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, për periudhën e vazhimit të lejes, është e detyruar të punojë në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Ligjin për Media, rregulloret e miratuara në bazë të Ligjit, si dhe të kushteve miratuara në leje.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

5. Padia nuk e anulon kryerjen(përmbarrimin) e këtij Vendimi.

A r s y e t i m

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

Në nenin 79 (Kohëzgjatja e lejes për transmetim televiziv ose radio) paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale - LSHMAAV, parasheh se leja për transmetim televiziv ose radio për Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive dhe institucionet radiodifuzive jofitimprurëse u jepet për një periudhë kohore prej nëntë vjetësh me mundësi vazhdimin e tyre.

Në pajtim me nenin 79 paragrafi (2) të LSHMAAV, leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive nuk mund t'i bartet një personi tjetër.

Leja për transmetim televiziv ose radiotransmetim në pajtim me nenin 79 paragrafi (3) të LSHMAAV mund të vazhdohet me kërkesë të poseduesit për një periudhë prej nëntë vjetësh. Kërkesa dorëzohet në Agjencion në afat jo më gjatë se gjashtë muaj para skadimit të vlefshmërisë së lejes. Këshilli i Agjencisë detyrimisht duhet të marrë vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për vazhdimin e lejes, nëse transmetuesi nuk ka kryer shkelje në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

Në pajtim me nenin 79 paragrafi (4) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë merr vendim për refuzimin e kërkesës për vazhdimin e lejes nëse transmetuesi ka kryer shkelje serioze gjatë kohëzgjatjes së lejes dhe atë: - së paku tri herë gjatë kohëzgjatjes së lejes ka kryer mosrespektim të ndalesave të veçanta të nenit 48 të këtij ligji, për të cilat ka aktgjykime të formës së prerë ose – gjatë kohëzgjatjes së lejes, në të paktën një cikël zgjedhor të mbulimit mediatik nuk është kryer në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, për të cilat ka aktgjykime të formës së prerë.

SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, është posedues i Lejes për transmetim televiziv PA1 nr.08-353 datë 30.06.2016, me vlefshmëri prej 9 (nëntë) vjetësh, me fillim nga data 24.06.2016 deri më datën 23.06.2025, për transmetim përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar, në nivel lokal, me zonë të transmetimit: Komuna Kërçovë, Komuna Pllasnic dhe Komuna Makedonski Brod, shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën shqipe dhe maqedonisht.

Me datë 09.01.2025, SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, në pajtim me nenin 79 paragrafi (3) të LSHMAAV, parashtrroi Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim TV (PA1 nr.08-5 datë 09.01.2025) në formular përkatës të publikuar në ueb-faqen e Agjencisë.

Pas shqyrtimit të lëndës Kërkesë, është konstatuar se është e pakompletuar, për shkak se përveç Deklaratës së transmetuesit, e noterizuar se do t'i respekton karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuara nga Agjencia për komunikime elektronike e RSM-së në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike dhe rregulloret e miratuara në bazë të ligjit; do të respektohen dhe kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim në radio dhe televizion miratuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale; nuk shkel dispozitat e Kapitullit IV të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha shtojcat janë të besueshme dhe të vlefshme, dhe pajtim për përpunimin e të dhënave personale të specifikuar në Kërkesën për vazhdimin e lejes, mungonte vetëm dokumenti përkatës si dëshmi se transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie që ndalon kryerjen e veprimtarisë nga regjistri ose evidencë (procesverbal) (në origjinal ose kopje e noterizuar dhe jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit), ose deklaratë nga drejtuesi i transmetuesit se nuk i është shqiptuar masë sigurie që ndalon kryerjen e veprimtarisë, e noterizuar (dhe jo më vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit).

Për sa më sipër, Agjencia kërkuesit për vazhdimin e lejes me datë 16.01.2025, i dërgoi shkresë me shkrim-Njoftim për plotësimin e kërkesës, PA1 nr.08-5 datë 16.01.2025, se është e nevojshme plotësimi i menjëhershëm i Kërkesës, si mund të vazhdohet me procedurë për vazhdimin e lejes në afatin e përcaktuar ligjor. Kërkuesi me datë 17.01.2025, drejtuar Agjencisë dorëzoi dokumentin përkatës – Vërtetim për sanksion kundërvajtës, nr.0808-50/151620250000053 datë 17.01.2025, e dhënë nga Regjistri Qendror i RMV-së (PA1 nr.08-5 datë 17.01.2025) me të cilën ka plotësuar Kërkesën për vazhdimin e lejes për transmetim TV (PA1 nr.08-5 datë 09.01.2025), ku është konstatuar se lënda kërkesë është e rregullt dhe e plotë.

Pas mbikëqyrjes së kryer të punës së transmetuesit gjatë kohëzgjatjes së lejes nga Agjencia, është konstatuar se kërkuesi – SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 79 të LSHMAAV, respektivisht nuk ka kryer shkelje serioze të përcaktuara në nenin 79 paragrafi (4) të LSHMAAV.

Duka marrë parasysh sa më sipër, dr. Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë drejtuar Këshillit të Agjencisë dorëzoi Propozimin, PA1 nr.08-22 datë 28.01.2025, për marrjen e vendimit për vazhdimin e Lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-353 datë 30.06.2016, vlefshmëria e të cilës prej nëntë vjetësh skadon me datë 23.06.2025, dhe e njëjta të vazhdohet çdo 9 (nëntë) vjet, respektivisht nga 24.06.2025 deri më 23.06.2034.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10, neni 24 të LSHMAAV dhe neni 79 nga Ligji i njëjtë, në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 57 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë dhe neni 51 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit të Kontesteve Administrative, duke vepruar sipas Kërkesës së parashtruar për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-5 datë 09.01.2025, me plotisimin, PA1 nr.08-5 datë 17.01.2025, Këshilli i Agjencisë në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-365/3 datë 30.01.2025, miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit do të botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në ueb-faqen e Agjencisë. SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, Agjencia për vazhdimin e vlefshmërisë së lejes nga pika numër 1. e këtij Vendimi, do t'i jipet leje e re. Transmetuesi është i detyruar të punon në pajtim me LSHMAAV, LM, rregullat e miratuara në bazë të ligjit, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje. Padia nuk e anulon përmbarimin e Vendimit.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi nga pika 1. e vendimit, ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.